kur falej i Dërguari i Allahut ﷺ, i hapte krahët, saqë i shihej bardhësia e nënsqetullave

Abdullah ibn Malik ibn Buhajne (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se, kur falej i Dërguari i Allahut ﷺ, i hapte krahët, saqë i shihej bardhësia e nënsqetullave.
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Kur Profeti ﷺ bënte sexhde, i hapte krahët gjatë saj dhe secilin krah e largonte nga ijët e ato hapeshin si krahët e shpendit, derisa i dukej ngjyra e lëkurës së nënsqetullave. Ngjyra e nënsqetullave dukej për shkak të hapjes dhe largimit të tepërt të krahëve nga ijët.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3220